



# UNIVERSITETI I SHKODRËS

## *"Luigj Gurakuqi"*

### SENATI

Nr. 4062 prot.

Shkodër, më 09. 11. 2016

### RELACION

*Mbledhja e Senatit Akademik e datës 09.11.2016.*

Senati Akademik (SA) i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në mbledhjen e tij të dates 09.11.2016, trajtoi çështjet e mëposhtme:

1. Rishikimi i kontratave të punës për angazhim si personel akademik i ftuar në USH të pedagogëve të USH-së që i përkasin kategorisë "Profesor" e të dalë në pension gjatë vitit të kaluar akademik.
2. Të ndryshme:
  - a) Propozimin e Rektoratit për ndryshim të nenit 8 pika 3/c të Rregullores së ruajtjes së vendit të punës në USH në bazë të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH" neni 64 pika 1, të Statutit të USH-së neni 12 pika 5/r, neni 38 pika 2 dhe të Rregullorës së ruajtjes së vendit të punës në USH, neni 5 pika 1.
  - b) Propozimin e Rektoratit për ndryshim të nenit 26 pika 3 të Rregullores së brendëshme egzistuese të studimeve me kohë të plotë në Bachelor në USH, në mbështetje të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH" neni 33 pika 3 dhe nenit 38 pika 1/d; dhe në mbështetje të Statutit të USH neni 12 pika 5/r, neni 13 pika 3/l dhe nenit 13 pika 4.
  - c) Shqyrtimin e kërkesës së studentëve për rishikim të nenit 29 "Studenti kalues i një kursi" në Rregulloren e studimeve të ciklit të parë Bachelor të USH, të ndryshuar me vendim nr.407 të SA së USH, dt. 06.10.16, në mbështetje të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH" neni 33 dhe nenit 38 pika 1/d; Statutit të USH neni 12 pika 5/r, neni 13 pika 3/l dhe nenit 13 pika 4.
  - d) Shqyrtimin e kërkesës të ardhur në Rektorat për shtyerje afati studimi për tetë studentë të USH që kanë mbi gjashtë provime të mbetura mbi afatin maksimal të përcaktuar për të përfunduar studimet e programit të ciklit të parë me kohë të plotë, në mbështetje të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH" neni 33 pika 3 dhe nenit 38 pika 1/d; Statutit të USH



neni 12 pika 5/r, neni 13 pika 3/l dhe nenit 13 pika 4; Rregullorës së studimeve të ciklit të parë Bachelor me kohë të plotë të USH neni 36.

- e) Vlersimin e formatit të diplomës dypalëshe për Fakultetin e drejtësisë midis Universitetit të Napolit të Italisë dhe Universitetit të Shkodrës, në mbështetje të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në LAL e RSH" neni 33 pika 1.4 dhe nenit 38 pika 1/dh, neni 80 ; Statutit të USH neni 12 pika 5/f , neni 13 pika 3/g dhe nenit 13 pika 4.
- f) Shqyrtimin e kërkesës së Rektoratit për pagesën 30-70% të orëve mësimore të zhvilluara mbi ngarkesën normale mësimore të personelit akademik me kohë të plotë të USH, bazuar në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në LAL e RSH" neni 33 pika 1.4 dhe nenit 38 pika 1/dh, neni 80 ; Statutit të USH neni 12 pika 5/c,d , neni 13 pika 3/c,e dhe nenit 13 pika 4.

Përsa i përket pikës së parë të agjendës së mbledhjes, Senatit Akademik ju prezantua kërkesa e ardhur në Rektorat e dekanatve së bashku me emrat konkret të pedagogëve të dalë në pension gjatë vitit të kaluar akademik dhe që i përkasin kategorisë "Profesor" për angazhimin e tyre si personel akademik i ftuar në USH. Anëtarët e SA unanimisht kërkuan që të punohej për këtë nga strukturat përkatëse të USH sipas vendimit nr. 408 të SA të USH dt.06.10.16 për këtë çështje.

Gjithashtu SA morri në shqyrtim edhe disa çështje të tjera.

- a) Senati vlersoi propozimin e Rektoratit për ndryshim të nenit 8 pika 3/c "Punësim. Kritere të përgjithshme" në Rregulloren e ruajtjes së vendit të punës në USH për ta kufizuar nga nivel njësie kryesore që ishte në nivel njësie bazë apo ndihmëse hapsiren e përjashtimit nga konkurimi të kandidatëve që kanë lidhje familjare (bashkëshort/bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), lidhje gjinie (prindër, motër/vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj) apo lidhje krushqie (prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es, si dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjësit egzistues brenda së njëjtës njësi bazë apo ndihmëse ku kërkojnë të punësohen. Kjo ishte kërkuar për faktin se Gjykata kushtetuese ka hedhur poshtë VKM mbi neopotizmin dhe se njësitë kryesore të USH tashmë janë zgjeruar dhe do zgjerohen përsëri me hapjen e vendeve të tjera të punës. Pas diskutimeve të shumta, Senati e miratoi ndryshimin e këtij neni me 62.5% të votave të 16 anëtarëve prezent në mbledhje.
- b) Senati miratoi unanimisht propozimin e Rektoratit për ndryshim të Rregullores së brendëshme egzistuese të studimeve me kohë të plotë në Bachelor në USH në nenin 26 pika 3 për rregjistrimin nga studenti të pjesmarrjes në riprovim. Ky ndryshim kërkon që student i Bachelorit të rregjistrohet on-line për sezonin e riprovimeve që do jetë dy javë para fillimit të sezonit të provimeve simestrale të përcaktuara në strukturën mësimore të miratuar dhe datat e riprovimeve do shpallen on-line pasi të jetë bërë rregjistrimi on-line i studentëve për riprovime. Ky ndryshim u bë për administrim më të mirë të riprovimeve dhe të auditorve të USH gjatë riprovimeve.
- c) Gjithashtu Senati vlersoi kërkesën e studentëve për rishikimin nga SA të nenit 29 "Studenti kalues i një kursi" në Rregulloretn e studimeve të ciklit të parë Bachelor, të




ndryshuar nga SA në mbledhjen e dt. 06.10.16 në mënyrë që t'i jepej mundësia studentëve për të kaluar në vitin e tretë duke ulur në 20 bazen e pikë krediteve të grumbulluara në vitin e dytë. Anëtarët e SA (93%) nuk pranuan që të bëhej ky ndryshim i propozuar nga studentët me qëllim që studenti të motivohej më shumë për t'i kryer studimet brenda afatit të përcaktuar në ligjin e arsimit të lartë.

- d) Senati ra dakort (80%) për të shtyrë afatin e studimeve për vitin akademik 2016-2017 për studentët David Correj dhe Valentina Kurtaj të Gjuhë-Letërsisë; Angjelin Çukaj i Gjeografisë; Ervis Figuri, Evis Cara, Alfred Morena, Moris Vila të Historisë; Alban Petoku i Informatikës të cilët kanë më shumë se gjashtë provime të mbetura mbi afatin maksimal të përfundimit të studimeve Bachelor.
- e) Anëtarët e SA vlersuan formatin e diplomës dypalëshe për Fakultetin e drejtësisë midis Universitetit të Napolit të Italisë dhe Universitetit të Shkodrës. Ata ranë dakort unanimitisht për formatin e propozuar të diplomës duke i bërë vetëm disa ndryshime të vogla nga ana estetike.
- f) SA miratoi unanimitisht kërkesën e Rektoratit për pagesën 30-70% të orëve mësimore të zhvilluara nga personeli akademik me kohë të plotë të USH mbi ngarkesën normale mësimore të tyre. Kjo u kërkuar në mënyrë që të ruhej cilësia e mësimdhënies dhe të mirëadministrohej procesi mësimor në USH.

Relacioni mbi mbledhjen e Senatit Akademik të USH-së të datës 09.11.2016 do të pasqyrohet në ëebsite të USH-së.

**Sekretari i Senatit**

**Prof. as. dr. Mirjam Dibra**



**Kryetari i Senatit**

**Prof. dr. Adem Bekteshi**

